Kronikë

Sherr në Himarë, u konfliktuan me dy vëllezer dhe i kërcënuan duke qëlluar me pistoletë ne ajër! Në pranga 2 persona, nën hetim 2 të tjerë

Një konflikt i nisur për motive të dobëta ka agravuar në një sherr të ashpër mes pesë personave në Himarë. Dy kushërinj, njëri nga të cilët është vënë në pranga ndërsa tjetri është ende në kërkim janë pasi janë konfliktuar me dy vëllezër, i kanë kërcënuar këta të fundit duke qëlluar me armë zjarri në ajër.

Redaksia
30 Korrik, 09:58 | **Përditësimi: 30 Korrik, 10:30**

Një konflikt i nisur për motive të dobëta ka agravuar në një sherr të ashpër mes pesë personave në Himarë. Dy kushërinj, njëri nga të cilët është vënë në pranga ndërsa tjetri është ende në kërkim pasi janë konfliktuar me dy vëllezër, i kanë kërcënuar këta të fundit duke qëlluar me armë zjarri në ajër.

Një konflikt i nisur për motive të dobëta ka agravuar në një sherr të ashpër mes pesë personave në Himarë. Dy kushërinj, njëri nga të cilët është vënë në pranga ndërsa tjetri është ende në kërkim janë pasi janë konfliktuar me dy vëllezër, i kanë kërcënuar këta të fundit duke qëlluar me armë zjarri në ajër.

LEXO EDHE:
Shkeli perimetrin e sigurisë gjatë lundrimit, duke rrezikuar jetën e pushuesve! Bllokohet skafi në Ksamil dhe gjobitet drejtuesi i tij

Mësohet se ngjarja ka ndodhur ditën e djeshme, në një lokal në plazhi e Bunecit, në Himarë, ku pas marrjes së njoftimit se disa persona të armatosur po konfliktoheshin fizikisht me njëri-tjetrin, policia ka shkuar menjëherë në vendngjarje.

Sipas njoftimit të policisë sherri dyshohet se ka nisur për motive të dobëta mes dy kushërinjve E. V. dhe A. V., të cilët janë konfliktuar fillimisht fizikisht me dy vëllezërit N. L. dhe A. L.

Pasi janë zënë me njëri-tjetrin, dy kushërinjtë kanë qëlluar me armë zjarri në ajër për të kërcënuar dy vëllezërit.

Për pasojë janë vënë në pranga 2 persona, 2 janë lënë nën hetim ndërsa një tjetër është shpallur në kërkim.

Konkretisht E. V., 42 vjeç, banues në Himarë, u arrestua për armëmbajtja pa leje, kanosje dhe plagosje e lehtë me dashje.

42-vjeçari aktualisht ndodhet në spital, në ruajtje nga shërbimet e Policisë, pasi ka pësuar dëmtime fizike gjatë konfliktit.

Sa i përket dy vëllezërve të përfshirë në konflikt, njëri prej tyre u arrestua ndërsa tjetri u la nën hetim.

N. L., 44 vjeç, u arrestua për fshehje të së vërtetës dhe mbajtja pa leje e armëve të gjahut.

Ndërsa, nisi procedimi penal në gjendje të lirë për A. L., 38 vjeç.

Gjatë kontrollit në banesën e N. L. u gjetën dhe u sekuestruan 2 armë gjahu, ndërsa në banesën e E. V., shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan 1 krehër arme zjarri pistoletë, 1 shënjestër optike për snajper. Gjithashtu, në lidhje me këtë ngjarje janë sekuestruar 1 automjet tip "Audi" dhe 1 aparat celular.

Materialet iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

M.T/Shqiptarja.com

TAG: sherr Vlorë himare

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Mendoni se rikthimi i Bashës në krye e ringre PD-në?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Anija turistike me 28 persona në bord pësoin defekt në zonën e Karaburunit, policia i shkon në ndihmë! Në Spille rrezikuan të mbyteshin babai dhe djali 9 vjeç
29 Korrik, 18:25



FOTOT/ Ekonomistja zgjedh artizanatin pas 15 vjetësh karrierë
29 Korrik, 12:53

Tentoi të korruptonte policin e Rrugores për t'i shpëtuar gjobës, vihet nën hetim 25-vjeçari në Sarandë
29 Korrik, 12:07

PD zgjedh sot kryetarin e ri, krerët e degëve në Vlorë e Korçë: S'ka problematika pjesëmarrje e ulët, procesin se ka ndalur dot Berisha e jo më Bardhi
29 Korrik, 11:40

Iu prish skafi dhe kishin mbetur në det të hapur, policia ju vjen në ndihmë 5 pushuesve në Karaburun
28 Korrik, 22:12

Vlora Marina Residences sjell hotelin me 5 yje Marriott, i pari në bregdetin shqiptar! Apartamentet e branduara, inovacioni i këtij bashkëpunimi
28 Korrik, 20:43

Mashtrimi me Call Center-at, kapet në Himarë një nga të kërkuarit, shkon në 10 numri i të arrestuarve
28 Korrik, 13:08

Gjendet një grua e mbytur në Portin e Vlorës
26 Korrik, 20:41

VIDEO/ Pushimet e Ivanka Trump në Shqipëri me jahtin luksoz në Karaburun
26 Korrik, 17:04

Rithemelimi: Zjarrin në ladfillin e Vlorës ta hetojë SPAK
26 Korrik, 16:34

Lundroi brenda perimetrit të sigurisë duke rrezikuar jetën e pushuesve në Ksamil, gjobitet me 200 mijë lekë drejtuesi! I bllokohet mjeti
26 Korrik, 15:38



Vajza e Donald Trump vazhdon pushimet në Shqipëri, me jahtin luksoz vizitojnë bukuritë e Jalës dhe Karaburunit
26 Korrik, 12:53

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje